



Pranimi / Dorezuar Prilijeni/Prudato Received / Delivery	04.03	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSHEK	1196	2022	1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.95/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2042/2021 të datës 01.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.591/2021 të datës 25.06.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë në çështjen juridike "kompensim material", kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.591/2021 e datës 25.06.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Ferizajt sipas ndryshim dhe plotësimit të akt emërimit të datës 01.07.2014 në vendin e punës "Zyrtarë i Logjistikës", dhe me datë 01.02.2021 me numër 01Nr.01-10/2021 të Kryetari i Komunës së Ferizajt merr vendimin me të cilin i përfundon marrëdhënia e punës nga data 09.06.2021 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe po ashtu me këtë vendim ankuesit i njihet e drejta e kompensimit të një (1) page mujore tw njëhershme në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi me datë 20.05.2021 parashtron ankesë tek Zyra e Personelit në Komunën e Ferizajt, me pretendim ankimor për mos pagesën e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit si dhe dy pagave jubilarë siç parashihet me marrëveshjen kolektive.

Menaxherja e Personelit me datë 31.05.2021 i kthen përgjigje në kërkesë/ankesë ankuesit me të cilin e njofton se: "meqenëse ju ende jeni në marrëdhënie pune në administratën e komunës së Ferizajt

uett me titullin 09.06.2021 (titulli i cili uo te pensionerit), nuk ka mundur ende te percjelle formimin e per pagesen e nje page ne menyre retroaktive me rastin e pensionimit tuaj, bazua ne legjislacionin ne fuqi", te cilen pergjigje ankuesi e pranon me date 09.06.2021 dhe me date 21.06.2021 parashtron ankesen ne Keshillin e Pavarur Mbikedyres per Sherbimin Civil te Kosoves nepermjet Postes se Kosoves, te cilen ankesen Keshilli i Pavarur Mbikedyres per Sherbimin Civil te Kosoves e ka pranuar me date 25.06.2021 me numer te protokollit 3305/2021 me pretendim ankimor per kompensimin e pagave percjellese me rastin e pensionimit dhe shperblimin e pagave jubilar sipas Marrveshjes se Pergjithshme Kolektive te Kosoves.

Keshilli i Pavarur Mbikedyres per Sherbimin Civil te Kosoves me date 01.07.2021 ka derguar kerkesen per pergjigje ne ankesen e ankuesit ne Komunen e Ferizajt. Me date 27.07.2021 Keshilli ka pranuar pergjigjen ne ankesen nga Komuna e Ferizajt me provat e bashkangjitura te lendes faqe 1/6.

Keshilli i Pavarur Mbikedyres per Sherbimin Civil te Kosoves, nga muaji janar i vitit 2019 deri me date 08.10.2020 ka qene jo funksional dhe nuk ka vendosur per ankesen e ankuesit, ndersa me date 09.08.2021, Keshilli i Pavarur Mbikedyres per Sherbimin Civil te Kosoves ka njoftuar ankuesin per arsyet e mos shqyrtimit te ankeses duke udhezuar qe mund te ndiqni procedurat e metejme dhe se ne pajtim me Ligjin per Konfliktin Administrativ mund te filloni proceduren gjyqesore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 01.02.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2042/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Keshillit të Pavarur Mbikedyres për Sherbimin Civil të Kosovës të datës 09.08.2021 dhe duke detyruar Keshillin e Pavarur Mbikedyres për Sherbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 25.06.2021. Keshilli i Pavarur Mbikedyres për Sherbimin Civil të Kosovës me datë 04.02.2022 me numër të protokollit 533/2022 e ka pranuar Aktgjykimin A.nr.2042/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Pas pranimit të Aktgjykimit A.nr.2042/2021 të datës 01.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 07.02.2022 kemi pranuar parashtrësën nga ankuesi i cili na ka njoftuar se tani e përfaqëson Avokat dhe kërkon nga Keshilli që përfaqësuesit të tij dërgohen shkresat.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 25.06.2021 e parashtruar në Keshillin e Pavarur Mbikedyres për Sherbimin Civil të Kosovës; Libreza e punës; Vendimi i datës 01.02.2021; Ankesa e ankuesit e datës 20.05.2021 e parashtruar në Zyrën e Personelit të Komunes së Ferizajt; Pergjigja në kërkesë e datës 31.05.2021 e Menaxheres së Personelit; Akt percjellësi i datës 07.06.2021; Kopja e letër njoftimit të ankuesit; Akt emërimi i ankuesit i datës 01.07.2011; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i datës 01.07.2014; Lista e pagave për muajin qershor 2021; Kërkesa për pagesë retroaktive si dhe pergjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lendës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e pazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se me rastin e pensionimit punëdhënësi është i detyruar që t'ia paguaj tri paga jubilarë dhe tri paga përcjellëse me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e i cili pretendim ankimor i ankuesit është i pazuar, sepse për kompensimet e nëpunësve civil janë të aplikueshme dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe në bazë të këtij ligji nëpunësve civil me rastin e pensionimit ju takon kompensimi në vlerën e një page të njëhershme të pagës së fundit, e jo tri (3) pagave siç ankuesi pretendon, e kjo është e përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil që nëpunësi civil ka të drejtë të kompensohet me rastin e pensionimit dhe të dispozitave të nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, që përcakton se: *"1. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit. 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëherëshme në vlerën e pagës së fundit"*.

Në lidhje me kërkesën e ankuesit për pagesën e shpërblimit jubilar, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar që me dispozitat e nenit 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, është përcaktuar që: *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar që ankuesi ka pasur të drejtë të parashtror kërkesën për pagesën e shpërblimit jubilar pas arritjes së kohës *"prej dhjetë (10) vjetësh pune"* ashtu siç është përcaktuar saktë me dispozitat e nenit 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, ku është përcaktuar që: *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune"*, e që nënkupton që kjo kërkesë është paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi që ankuesi këtë kërkesë ka pasur të drejtë të parashtror para gjithsej shtatë (7) vite e pesë (5) muajve, gjegjësisht brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur e ka arritur kohën *"prej dhjetë (10) vjetësh pune"* pandërprerë në Komunën e Ferizajt.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit se me ligjin e punës dhe Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës sipas nenit 52 dhe 53 me rastin e pensionimit i takojnë tri paga mujore jubilarë si dhe tri paga përcjellëse dhe Kolegji ka konstatuar se, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë

31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Ferizajt, me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 01.02.2021 me numër 01Nr.01-10/2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit për ankuesin Zymer Bega si dhe njohjen e kompensimit e një page pas moshës së pensionimit, për nëpunësin civil Zymer Bega, është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është marrë në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Ferizajt, ka nxjerr Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të datës 01.02.2021 me numër 01Nr.01-10/2021 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me të cilin vendim ankuesit i njihet e drejta e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit pas moshës së pensionimit, sipas dispozitave ligjore të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime dhe Kolegji në bazë provave të lëndës ka konstatuar se ankuesit iu është bërë pagesa në vlerë prej 446.26 Euro (katërqind e katër te gjashtë Euro e njëzet e gjashtë cent) në bazë të Kërkesës për Pagesë Retroaktive të datës 08.06.2021.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.95/2022

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt;
- Arkivit të KPMSHCK- së.